REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primljeno/Predato Recieved/Delivery	12 - 11 201 8		viti god year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	6767/2018		1/2

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.616/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Lulzim Aliaj-kryetar, Gjylinaze Gola dhe Malsore Gashi-Bajraktari -anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.616/2018 të datës 01.10.2018 të parashtruar nga ankuesi Artan Ibërhysaj nga Prishtina kundër organit të punësimit-Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike „kompensim material" dhe duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 12.11.2018, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.616/2018 të datës 01.10.2018 të parashtruar nga ankuesi Artan Ibërhysaj.

A r s y e t i m

Ankuesi Artan Ibërhysaj i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës sipas Akt Emërimit të datës 28.09.2015 në pozitën „Administrator i lartës i TI-së për sisteme'', me datë 24.08.2018 i është drejtuar me kërkesë Komisionit për Shqyrtimin e Shtesave në Ministrinë e Administratës Publike për realizimin e shtesës në pagë në vlerën prej 400 euro, sipas vendimit nr.02/39 të datës 08.10.2008 si dhe duke pretenduar se është e gjetur edhe nga raporti i Auditorit Gjeneral për vitin 2017.

Ankuesia kundër heshtjes administrative të Komisionit për shqyrtimin e shtesave në Ministrinë e Administratës Publike, me datë 01.10.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5631/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me datë 03.10.2018 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Këshilli me datë 05.10.2018 ka pranuar përgjigje nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me shkresat e bashkëngjitura lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 01.10.2018 e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli 5631/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 24.08.2018 me numër protokolli 2740 në Komisionin për Shqyrtimin e shtesave në Ministrinë e Administratës Publike; Ankesa e datës 23.11.2016 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimi i Këshillit me numër A/02/62/2017 i datës 11.04.2017; Vendimi nr.01/39 i datës 08.10.2008; Raporti i Auditorit Gjeneral për vitin 2017; Letër e konfirmimit e datës 02.05.2016; Përgjigje në ankesë e datës 05.10.2018; Vendimi i datës 16.01.2017; Ankesë e datës 23.11.2016; Akt emërimi i datës 28.09.2015 si dhe shkresat e tjera të bashkëngjitura lëndës.

REPUBLIKA E KOSOVËS - KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS - SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS - KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS - KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS - SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS - KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS - KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS - SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS - KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS - KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS - SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS - KOSOVO

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore për përfundimin e procedimit lidhur me ankesën e ankuesit Artan Ibërhysaj.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar ankesën e ankuesit dhe të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke vendosur për ankesën e ankuesit me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, me datë 11.04.2017 ka nxjerr Vendimin me numër A/02/62/2017, me të cilin e ka hedh poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit Artan Ibërhysaj, pasi që ka konstatuar se ankuesi Artan Iberhysaj, sipas Akt Emërimit të datës 28.09.2015 është avancuar në pozitën „Administrator i Lartë i TI për Sisteme" , ndërsa me datë 30.10.2016 te udhëheqësi i personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës ka bërë kërkesë për rishikimin e nivelit të shtesave për pozitën „Administrator i Lart i TI për Sisteme" nga 200 € në 400 €, ndërsa me datë 23.11.2016 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës, për realizimin e shtesave në bazë të Vendimit të Qeverisë me numër 02/39 të datës 08.10.2008.

Duke marr parasysh dispozitat e nenit 101 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku është përcaktuar se: *„Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike"*, si dhe faktin që Këshilli ka vendosur me Vendimin me numër A/02/62/2017 të datës 11.04.2017 për ankesën e ankuesit të datës 16.02.2017 me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka vendosur për përfundimin e procedurës administrative lidhur me ankesën e ankuesit të datës 01.10.2018.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se me dispozitat e Rregullores Nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civilë, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin me numër 04/109 me datë 19.12.2012, është përcaktuar që *„Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës lidhur me shtesat dhe kompensimet mbi pagën bazë të nëpunësve civilë''*, dhe në pajtim me këtë rregullore, zyrtarët përgjegjës janë të obliguar që të zbatojnë këto dispozita lidhur me shtesat dhe kompensimet e nëpunësve civilë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamentin për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.616/2018

Lulzim ALIAJ	**Zyle Millaku-Gojnovci**
Kryetar i Kolegjit	**Procesmbajtëse**

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit Artan Ibërhysaj;*
- *Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administratës Publike;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave;*
- *Udhëheqësit të Personelit të Shërbimit Korrektues;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*